

V E N D I M
Nr.320, datë 11.7.1994

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.138, DATË
31.3.1994 “PËR KOMPENSIMIN E SHPENZIMEVE NGA NDRYSHIMI I ÇMIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE DHE LËNDËVE DJEGËSE”**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit e Përkrahjes Sociale dhe të Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 31.3.1994, bëhen këto ndryshime:

1. Në kreun I

a) Në pikën 2 shkronja “f” ndryshohet si vijon:

“Personat që marrin ndihmë ekonomike sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.40, datë 29.1.1993 “Për ndihmën ekonomike për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë”, si dhe sipas pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.59, datë 18.3.1993 “Për trajtimin e të huajve që strehohen në Republikën e Shqipërisë”.

b) Pika 7 ndryshohet si vijon:

“Në masën deri në 700 lekë në muaj:

- Familjet të cilat kanë vetëm një person që përfiton kompensim sipas pikës 2, shkronjat “a”, “b”, “c”, “f”, si dhe sipas pikës 3, me përjashtim të familjeve bujqësore, dhe nuk përfiton ndihmë ekonomike”.

c) Shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“Për përfitimin e këtij kompensimi nuk merret parasysh ndarja e familjes pas datës 30.6.1993, me përjashtim të rastit kur brenda saj krijohet kurorë e re. Në këtë rast familje konsiderohen prindërit dhe fëmijët që ata kanë në ngarkim, si dhe çdo person tjetër, të cilët bashkëjetojnë ekonomikisht në të njëjtën shtëpi sipas nenit 3, pika 1 e ligjit nr.7710, datë 18.5.1993”.

2. Në kreun III

a) Në pikën 1, shkronja “a” hiqet fjala “e jobuxhetore” dhe në fund të kësaj shkronje shtohen fjalët “dhe për repartin ushtarak nr.9186”.

b) Në pikën 1 shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“Për ndërmarrjet dhe institucionet jobuxhetore përballohen nga buxheti i shtetit deri në masën 300 lekë.

Pagesat sipas pikës 7, kreu I, përballohen nga fondet e vetë ndërmarrjes a institucionit jobuxhetor”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi